

Ndërsa në ajetin 2:190 lexojmë, All-lahu nuk urdhëron myslimanët që të shkojnë në ekstreme duke thënë, **“Mos e teproni.”** Lufta nuk është justifikim për të kaluar kufijtë (për ta tepruar). Islami na mëson distancimin nga hakmarrja e verbër.

## Terrorizmi në perspektivë

Problemi me vënien e terrorizmit në perspektivë është se nuk ka asnjë përkufizim të caktuar mbi atë që përbën “terrorizmi”. Gjithashtu, terrorizmi merr shumë forma, siç e tregojnë shembujt e mëposhtëm.

*Robert Fisk*, nga *The Independent*, shkruan: “Izraeli dhe aleatët izraelitë (më 16 shtator 1982) filluan shfrenimin e tyre tre ditor të përdhunimeve, therjeve dhe vrasjeve në kampet palestinezë të refugiatëve Sabra dhe Shatila, që u kushtoi jetën 1.800 palestinezëve. Më pas vijoi pushtimi Izraelit i Libanit i dizajnuar për të përzënë OÇP (Organizatën Çlirimtare të Palestinës) nga vendi duke e pasur parasysh (miratimin nga Shtetet e Bashkuara) që u kushtoi jetën 17.500 libanezëve dhe palestinezëve, shumica prej tyre civilë.”

Sipas Profesor *Noam Chomsky*, “Është e padiskutueshme se Shtetet e Bashkuara janë një shtet udhëheqës terrorist. Në fakt, është shteti i vetëm që ishte i dënuar për terrorizëm ndërkombëtar nga ana e organeve më të larta: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në 1986.”

Në mënyrë të ngjashme, “Masakra e tmerrshme e 8000 muslimanëve – disa të paarmatosur - në Srebrenicë në vitin 1995 kurrë nuk çoi në përfundimin se krishterimi është i dhunshëm dhe ka tendencia represive.”

*William Dalrymple*, *The Independent UK*.

“Kërditë e shkaktuara nga perëndimorët, gjoja të krishterë dhe kërët e tyre, gjatë gjashëtë dekadave të fundit janë një luftë botërore dhe një luftë e ftohtë, një Holokaust, dy bomba atomike, shtypja e luftrave për pavarësi, nxitja e luftërave, si dhe përkrahja e diktatorëve dhe terroristëve shtetërorë dhe jo-



“Dhe të mos u shtyje urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë.”  
*Kur'an 5:8*

shtetërorë - e bëjnë të pamundshëm shikimin e Islamit si një fe ose qytetërim më i dhunshëm se kaq.”

*Rama Mani (Qendra e Gjenevës për Politikën e Sigurisë)*

Ka shumë shembuj të tjerë hebraikë dhe të krishterë të terrorizmit, megjithatë, ne kurrë nuk duhet të flasim në përgjithësi dhe të thërrasim të gjithë të krishterët dhe çifutët terroristë. Në mënyrë të ngjashme, ne nuk duhet ti gjykojmë të gjithë myslimanët, por vetëm ata që kanë kryer krimin duhet të gjykojen.

## Islami dënon terrorizmin

Akti për nxitjen e terrorizmit në zemrat e civilëve të pambrojtor, shkatërimin e ndërtesave dhe pronave, bombardimet dhe gjyntimi i burrave, grave dhe fëmijëve të pafajshëm, të gjitha janë të ndaluara si dhe në bazë të Islamit dhe muslimanëve janë akte të neveritshme. Kjo qëndron për çdo lloj terrorizmi, duke përfshirë terrorizmin e sponsorizuar nga shtetet perëndimore i cili ka vrarë, ka plagosur dhe ka detyruar të zhvendosen njerëz pafundësish më shumë se të gjitha llojet e tjera të terrorizmit.

“All-lahu nuk ju ndalon të bëni mirë dbe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuani prej shtëpisë tuaja; All-lahu i do ata që mbajnë drejtësinë.”  
*Kur'an 60:8*

Nëse një individ musliman ka kryer një akt të terrorizmit, ky person do të jetë fajtor për shkelje të ligjeve të fesë të cilën ata e pretendojnë ta ndjekin - Islamin. A do të jetë e drejtë të dënohen të gjithë muslimanët, kur feja në vetvete është kundër akteve të tillë? Muslimanët ndjekin një fe të nënshtrimit ndaj Zotit, të paqes, mëshirës dhe faljes. Shumica nuk kanë të bëjnë asgjë me ngjarjet e dhunshme të cilat, veçanërisht mediat, i kanë lidhur me muslimanët. Islami nuk është një fe e ekstremizmit.

**Informacion**  
tel 045 633 370 web [islamifejaevertete.com](http://islamifejaevertete.com) @ broshurat@gmail.com  
**Emri i bankës** Pro Credit Bank  
**Kontoja** 1184001037000102 **Swift** MBKORS22

**Islami nuk është  
fe e  
ekstremizmit**

“...Kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t’i kishte mbytur gjithë njerëzit...”  
*Kur'an 5:32*

**gjërat  
themelore**

[islamifejaevertete.com](http://islamifejaevertete.com)

# Islami... fe ekstreme?

“Terroristë islamikë!” “Fundamentalistë muslimanë!”

“Ekstremistë!” “Radikalë islamikë!” - janë këta vetëm disa nga emëritimet që u janë mveshur gabimisht muslimanëve në këto vitet e fundit.

Portretimi i Islamit nga mediat shpesh mashtron ata që kanë njoħuri tē kufizuar pér këtë fe dhe i shtyen që tē bējnë supozime negative līdhur me këtë ményré shumë tē qetë dhe tolerante tē jetës.

Peter Manning, gazetar australian që prej 30 vitesh deklaron në librin e tij, **“Ne dhe Ata”**:

“Përvoja ime tregon se ka një dallim tē madh në mes tē realiteteve tē jetës së përditshme tē arabëve dhe muslimanëve australianë dhe ményrës se si ata paraqiten në mediat tona (australiane).

Në më shumë se 60 përqind tē rasteve (nga shkrimet e 2 gazetave kryesore (në perëndim), fjalët ‘dhunë’, ‘vdekje’, ‘sulm’, ‘vrasje’, ‘vetëvrasje’ ose ‘të armatosur’ ishin në afërsi të fjalëve ‘arab’, ‘palestinez’, ‘musliman’ apo ‘islam’.”

A është atëherë ndonjë çudi, që shumica e njerëzve Islamin e shoqerojnë me terrorizëm?

Problemi i injorancës është vënë në pah nga një studim (në Australi) i cili tregoi se më shumë se një në tre australianë pranojnë se nuk dinë asgjë pér Islamin dhe pasuesit e tij.

“Ata me më së paku njoħuri dhe kontakte personale me muslimanët kishin shumë tē ngjarë që tē ndjehen tē kërcënuar nga Islami,” - tha Dr. Dunn, i cili është autorizuar nga Institutti Australi-Indonezi pér kryerjen e studimit.

Përhapja e paragjykimeve dhe injorancës nga mediat līdhur me Islamin mund tē kundërshtohet nga kuptimi i Islamit përmes mësimeve tē duhura tē tij. Kjo do tē thotë duke iu referuar Kur'anit (që muslimanët besojnë se është fjala e Zotit) dhe thënive autentike tē profetit Muhammed (paqja qoftë mbi tē). Përmes tē kuptuarit tē duhur tē këtyre mësimeve, do tē zbuloni se Islami është plotësisht kundër çdo forme tē ekstremizmit.

## Si mund tē keqkuptohet Kur'ani

Kur lexon Kur'anin, ose thëniet e Pejgamberit (paqja qoftë mbi tē), njeriu duhet kuptuar kontekstin në tē cilin formulimi vlen.

Ajeti vijues i Kur'anit është favoriti në mesin e atyre që kërkojnë tē largojnë njerëzit nga Islami:

**“Dhe luftoni ata kudo qé t'i zini, déboni prej vendit ata sikurse ju pérzuné ata juve. Provokimi (fitneja) është më e rendë se vrasja. Mos i luftoni ata pranë xhamisë së shenjtë (Mesxhidul-Haram) derisa ata t'ju luftojnë juve aty, e nëse ju sulmojnë, atëherë edhe ju i sulmoni ata. I këtillë është ndeshkimi ndaj pabesitmarrëve.”** Kur'an 2:191

Në raste tē caktuara, ky ajet shkurtohet rrezikshmërisht dhe paraqitet në këtë ményrë:

**“Dhe luftoni ata kudo qé t'i zini...”** Kur'an 2:191

Pyetja është e qartë: “Cilët t'i vrasin?”. Pér t'iui përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet tē lexohen ajetet paraprake dhe pasuese tē ajetit 2:191.

**“Dhe luftoni në rrugën e All-llahut kundër atyre qé ju sulmojnë e mos e teproni se All-llahu nuk i do ata qé e taprojnë (e fillojnë luftën).”** Kur'an 2:190

Ajeti i mësipërm përmend luftën si një mijet i vetëmbrojtjes (dmth. me ata qé ju luftuan). Ajeti pauses 2:191 është:

**“E nëse heqin dorë (nga provokimi). All-llahu është Ai qé fal dhe qé mëshiron.”** Kur'an 2:192

Këto ajete u zbritën në një kohë kur muslimanët ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre pér shkak tē besimit tē tyre. Ata duruan më shumë se dhjetë vjet persekutimi dhe përfundimisht u është dashur që tē largoheshin në një vend tē sigurt.

Ajetet e mësipërme u referohen idhujtarëve arabë tē Mekës gjatë kohës së Pejgamberit (paqja qoftë mbi tē), tē cilët i maltezon Muslimanët dhe planifikuan pér t'i sulmuar ata në vendin ku ata kërkuan strehim.

Andaj edhe ajeti i mësipërm mund tē aplikohet vetëm në rrithana tē tillë.

Ky shembull demonstron se ajetet në Kur'an duhet tē kuptohen në kontekstin e tyre tē duhur sepse këto ajete janë shpallur līdhur me situata tē veçanta, pér një periudhë prej 23 vjetësh. Është gjithashtu e rëndësishme tē theksohet se Kur'an është shpallur në arabisht. Prandaj, përkthimet në gjuhë tē ndryshme mund tē janë shpeshherë çorientuese ose tē pasakta.

## Lufta e lejueshme

Nuk mund tē ketë dyshim se muslimanët (si kushdo tjetër) kanë tē drejtën legitime pér tē luftuar kundër agresionit ose edhe kur janë tē shtypur.

Islami na mëson se lufta është e lejuar me qëllim tē ruajtjes së mirëgenies së komunitetit ose pér tē parandaluar përhapjen e shtypjes - kjo mund tē jetë në kontekstin e luftës mbrojtëse ose sulmuese, në varësi të situatës tē veçantë. Islami, ashtu si çdo ‘ményrë e jetës’ që dëshiron tē sigurojë mbijetesën e saj, ka tē drejtë tē mbrojë veten kur deklarohet luftë kundër tij. Në Kur'an (22:39), ne lexojmë:

**“Atyre tē cilët luftohen nga ndokush, u është dhënë leje tē luftojnë, pér shkak se u është bërë e padrejtë.”**  
Kur'an 22:39

Megjithatë, kur armiku pushon armiqësinë e tij, muslimanët janë tē urdhëruar tē pushojnë luftimet.

Ebu Bekri (All-llahu qoftë i kënaqur me atë), mik i afërt i Profetit Muhammed dhe pasardhësi i tij (në krye të shtetit islam), foli pér qasjen islamike ndaj luftës duke theksuar në vijim:

Në fushëbetëjë, nuk duhet:

- tē tradhëtosh
- tē masakrosh tē vdekurit
- tē devijosh nga rruga e drejtë
- tē vrasësh gra, fëmijë apo njerëz tē moshuar
- tē dëmtosh ose djegësh pemët, veçanërisht ato tē frytshmet
- tē therrësh bagëtinë e armikut, pëveç pér ushqim
- tē dëmtosh prijësit e tyre fetarë

**“Në qoftë se ata, anojnë kah paqja ano edhe ti kah ajo, e mbështetu në All-llahun. Është Ai qé dëgjon dbe di.”**  
Kur'an 8:61